

Worcester Public Schools
2021 Udhëzime për Diplomimin e Shkollës Tetë-Vjeçare

Dyert do të hapen për diplomimin një orë përpara fillimit të ceremonis.

Ju lutemi, vetëm të ftuar/a me bileta zyrtare do të lejohen të hyjnë. Në rast se bie shi, ceremonia do të zhvillohet nën një tendë të madhe, në një fushë ngjitur me fushën kryesore. Kujtohuni të merrni me vete një çadër!

Vendet për t'u Ulur, Maskat dhe Distancimi

Bazuar në udhëzimet e DESE, të ftuarit/at, të cilët/cilat nuk janë plotësisht të vaksinuar/a i këshillojmë të përdorin maska. Të gjithë/a të ftuarit/at janë veçanërisht të këshilluar/a të respektojnë distancën. Ata/ato të ftuar/a që nuk ndihen mirë apo janë duke përjetuar simptoma nuk duhet të marrin pjesë në mënyrë kategorike.

Jo Bori/Tullumbace/Tabela apo Sende të tjera festive


Në përputhje me mënyrën se si janë organizuar ceremonitë e mëparshme të diplomimit në WPS, **ju kërkohet t'i lini këto sende në makinë**, për t'i përdorur pas ceremonisë.

Këpucët për të Diplomuarit/at

Nuk lejohen këpucë me taka apo me shollë shumë të lartë. Përveç faktit se mund të dëmtojnë terrenin, takat mund të zhyten në tokë dhe kjo mund të shkaktojë dëmtime fizike. Kjo masë është për arsye sa sigurie, aq edhe mirëmbajtjeje.

Parkimi

Më poshtë gjeni një hartë me zona parkimi që gjenden shumë pranë me stadiumin. Çmimet mund të ndryshojnë. Të gjithë/a të ftuarit/at dhe personeli duhet të përdorin vendet e parkimit #1-4.



Pas Ceremonisë

Planifikoni të dilni menjëherë pas përfundimit të ceremonisë dhe të takoheni me fëmijët tuaj jashtë stadiumit. Bazuar në udhëzimet e DESE, nuk janë të lejuara grumbullime apo festime.